# Ligjërata 8

# RAPORTI:
# PAPUNËSI – INFLACION

- **Në këtë kapitull do të njiheni me:**
  - → *Arsyet pse papunësia bashkë me inflacionin paraqesin dy problemet kryesore makroekonomike*
  - → *Burimet e inflacionit (inflacioni: inercial, nga kërkesa dhe nga kostoja)*
  - → *Ndërlidhjen në mes të inflacionit dhe papunësisë*
  - → *Kurbën e Philipsit (në periudha afatshkurta dhe periudha afatgjata)*

# HYRJE

- Punëzënia e plotë dhe stabiliteti i çmimeve janë dy nga objektivat qendrore makroekonomike të secilës qeveri

- Të dyja janë gjendje te deshirueshme

- Por nuk arrihen ne te njejten kohe (ekziston nje trade-off ne mes tyre)

- Prandaj qeveria duhet te zgjedhe

# Norma e inflacionit për disa vende
## (% mesatare vjetore)

| Country | 1971–80 |
|---|---|
| [redacted] | 7.1 |
| France | 9.8 |
| [redacted] | 5.1 |
| Italy | 14.6 |
| [redacted] | 8.8 |
| Netherlands | 7.3 |
| [redacted] | 15.0 |
| Sweden | 9.6 |
| [redacted] | 13.2 |
| USA | 7.0 |
| [redacted] | 10.0 |

*European Economy Statistical Annex* (European Commission)

# Norma e inflacionit për disa vende (% mesatarev vjetore)

| Country | 1971–80 | 1981–90 |
|---|---|---|
| [redacted] | 7.1 | 4.2 |
| France | 9.8 | 6.3 |
| [redacted] | 5.1 | 2.5 |
| Italy | 14.6 | 10.0 |
| [redacted] | 8.8 | 2.2 |
| Netherlands | 7.3 | 2.4 |
| [redacted] | 15.0 | 9.2 |
| Sweden | 9.6 | 8.0 |
| [redacted] | 13.2 | 6.2 |
| USA | 7.0 | 4.5 |
| [redacted] | 10.0 | 6.2 |

*European Economy Statistical Annex* (European Commission)

# Norma e inflacionit për disa vende (% mesatarev vjetore)

| Country | 1971–80 | 1981–90 | 1991–2000 |
|---|---|---|---|
| | 7.1 | 4.2 | 1.9 |
| France | 9.8 | 6.3 | 1.8 |
| | 5.1 | 2.5 | 2.3 |
| Italy | 14.6 | 10.0 | 4.3 |
| | 8.8 | 2.2 | 0.4 |
| Netherlands | 7.3 | 2.4 | 2.4 |
| | 15.0 | 9.2 | 4.2 |
| Sweden | 9.6 | 8.0 | 3.0 |
| | 13.2 | 6.2 | 3.3 |
| USA | 7.0 | 4.5 | 2.2 |
| | 10.0 | 6.2 | 3.0 |

*European Economy Statistical Annex* (European Commission)

# Norma e inflacionit për disa vende
# (% mesatarev vjetore)

| | 1971–80 | 1981–90 | 1991–2000 | 2001–06 |
|---|---|---|---|---|
| | 7.1 | 4.2 | 1.9 | 1.9 |
| | 9.8 | 6.3 | 1.8 | 1.8 |
| | 5.1 | 2.5 | 2.3 | 1.3 |
| | 14.6 | 10.0 | 4.3 | 2.5 |
| | 8.8 | 2.2 | 0.4 | –1.2 |
| | 7.3 | 2.4 | 2.4 | 2.2 |
| | 15.0 | 9.2 | 4.2 | 3.0 |
| | 9.6 | 8.0 | 3.0 | 2.0 |
| | 13.2 | 6.2 | 3.3 | 1.9 |
| | 7.0 | 4.5 | 2.2 | 2.1 |
| | 10.0 | 6.2 | 3.0 | 2.0 |

*European Economy Statistical Annex* (European Commission)

# Norma e inflacionit për disa vende



# Inflation rates in selected industrialised countries



# Inflation rates in selected industrialised countries




© MAKROEKONOMIA

# Inflation rates in selected industrialised countries




© MAKROEKONOMIA

Dr. Avdullah Hoti

# Inflation rates in selected industrialised countries



# Inflation rates in selected industrialised countries




© MAKROEKONOMIA

# Inflation rates in selected industrialised countries



# Inflation rates in selected industrialised countries



# Inflation rates in selected industrialised countries




© MAKROEKONOMIA



Dr. Avdullah Hoti

# Inflation rates in selected industrialised countries




© MAKROEKONOMIA



Dr. Avdullah Hoti

# BURIMET E INFLACIONIT

- Ekzistojnë mendime të ndryshime lidhur me shkaqet / burimet e inflacionit

- Për diskutim veçojmë:
  - → INFLACIONI INERCIAL
  - → INFLACIONI NGA KËRKESA
  - → INFLACIONI NGA KOSTOJA

# INFLACIONI INERCIAL

- Inflacioni inercial: i parashikueshëm/pritshëm
  - norma e inflacionit është e qëndrueshme (inerciale)
  - në ekonomi nuk ndodhin ndryshime të rëndësishme në anën e kërkesës apo ofertës
- Te dhenta tregojne se inflacioni ne fakt ka qene inercial

# INFLACIONI INERCIAL

- Por pse inflacioni eshte inercial?
  - Për shkak të pritjeve të agjentëve ekonomik
    - *Teoria e Pritjeve Racionale/Theory of Rational Expectations – Robert Lukas dhe të tjerët*
- Pagat në të ardhmen përshtaten ndaj ritmit të rritjes së çmimeve në periudhën e tanishme
- Por, ndonjehere ndodhin ndryshime qe e levizin ekonomine nga ritmi afatgjate:
  - ndryshimet ne kerkese,
  - te korrat (AS),
  - ndryshimi i kursit valutor,
  - ndryshimi i produktivitetit etj.

# INFLACIONI NGA KËRKESA

- Inflacioni nga kërkesa rezulton nga një rritje e kërkesës agregate (AD), në kushtet kur oferta agregate (AS) nuk ka ndryshuar.

- Ndër faktorët që shpiejnë në rritjen AD janë:
  - → *Rritja në ofertën e parasë*
  - → *Rritja e shpenzimeve qeveritare (G) për të blerë mallra dhe shërbime*

# ...INFLACIONI NGA KËRKESA

***Fig 20.1: Inflacioni nga kërkesa***

- Kur AD ↑, kurba AD zhvendoset djathtas nga poziconi fillestar
- AS mbetet e pandryshuar
- Në S-T kemi ↑ të AS dhe çmimeve, në L-T kemi vetëm ↑ të çmimeve,
- Kjo shpie në ↑ e pagave duke i dhënë impuls të ri ↑ te cmimeve

Figura 20.1: Inflacioni nga kërkesa



# ...INFLACIONI NGA KËRKESA

**Spiralja Çmim – Pagë - Inflacion:**

- Pasi kjo rritje e çmimeve ka ardhur si rezultat i rritjes së AD, inflacioni si burim ka rritjen e kërkesës
- Kur *u* është nën nivelin natyror => kemi mungesë të punës => pagat rriten => AS zhvendoset lartë - majtas ndaj pozicionit të saj fillestar.
- Nëse nuk ka ndryshim në AD, ekuilibri i ri është aty ku pritet SAS1 me AD1

*Figura 20.2:* Rritja e shkallëzuar e inflacionit



# ...INFLACIONI NGA KËRKESA

Inflacioni i vazhdueshëm nga kërkesa

➲ Nëse kërkesa vazhdimisht rritet, AD zhvendoset

➲ Pagat rriten (pasi rriten çmimet)

➲ Zhvendoset AS majtas

*Figura 20.3:* Inflacioni i vazhdueshëm nga kërkesa



# <u>INFLACIONI NGA KOSTOJA</u>

- Shfaqet kur rriten çmimet si pasojë e rritjes së kostos (shpenzimeve - çmimeve të lëndëve të para)

- <u>Inflacioni nga kostoja, gjithashtu, ndodh si rezultat i këtyre faktorëve:</u>

  - → *Një rritje më e madhe në pagë se sa në produktivitetin e punës*

  - → *Një rritje në kursin e këmbimit të monedhës (zhvlerësim i monedhës) duke rritur kështu çmimin e materialeve të importuara*

  - → *Një rritje në çmimin e materialeve të importuar për shkaqe të faktorëve të jashtëm (OPEC 1973)*

  - → *Rritjes së taksave indirekte*

# INFLACIONI NGA KOSTOJA



# INFLACIONI NGA KOSTOJA



# INFLACIONI NGA KOSTOJA



# ...INFLACIONI NGA KOSTOJA

- Kurba AS zhvendoset lartë - majtas nga pozicioni fillestar
- Kjo ndodhë edhe atëherë kur GDP aktual < GDP potencial
- Kur GDP aktual < GDP potencial dhe kemi inflacion nga kostoja atëherë kemi rritje edhe të papunësisë.
- Gjendja ekonomike me papunësi të lartë dhe inflacion quhet stagflacion

*Figura 20.4*: Inflacioni nga kostoja



# ...INFLACIONI NGA KOSTOJA



# ...INFLACIONI NGA KOSTOJA



# ...INFLACIONI NGA KOSTOJA



# INTERAKSIONI AD-AS DHE INFLACIONI

– **Interaksioni i inflacionit nga kërkesa dhe nga shpenzimet**

# INTERAKSIONI AD-AS DHE INFLACIONI



# INTERAKSIONI AD-AS DHE INFLACIONI



# INTERAKSIONI AD-AS DHE INFLACIONI



# RAPORTI PAPUNËSI – INFLACION: KURBA E PHILIPSIT

- Kurba e Philipsit paraqet modelin teorik për analizimin e këtij raporti
- Qeveria duhet të luftojë si papunësinë ashtu edhe inflacionin
- Cili është raporti *papunësisë – inflacioni*, apo ç'ndodh me inflacionin kur qeveria lufton papunësinë ose anasjelltas?
- Ekonomisti Arthur Philips ka mbledhur të dhëna për vitet 1861-1957 për të parë se kush e përcakton pagën dhe inflacionin
- Arthur Philips gjeti një lidhje negative në mes të papunësisë dhe inflacionit
- Kjo lidhje negative ka tërhequr vëmendjen e hartuesve të politikave makroekonomike,
- Dilema është shfaqur në lidhje me atë se kush të luftohet më parë: inflacioni apo papunësia?

***Figura 20.5: Kurba e Philipsit***



# KURBA E PHILIPSIT: NE PERIUDHA AFATSHKURTRA

- Në periudha afatshkurtra (S-T), Kurba e Philipsit paraqet lidhjen inflacion - papunësi atëherë kur kemi normë konstante të inflacionit të pritshëm dhe normë konstante natyrore të papunësisë
- Kur inflacioni i pritshëm është 10% në vit dhe norma e papunësisë 6%, kurba e Philipsit kalon nëpër pikën *a*
- Nëse *u* rritet mbi 10%, atëherë inflacioni ulet nën atë të pritshëm (pika c)
- *Kjo lidhje (dhe kjo kurbë) mbetet kështu për sa kohë që inflacioni i pritshëm nuk ndryshon*

Kur inflacioni i pritshem ndryshon, kurba zhvendoset

*Figura 20.6*: Lidhja papunësi-inflacion në Kurbën PHilipsit



# KURBA E PHILIPSIT: NË PERIUDHA AFATGJAT

- **Kurba e Philipsit në periudha afatgjata (L-T) paraqet lidhjen inflacion-papunësi atëherë kur inflacioni aktual është i barabartë me normën e pritshme të inflacionit,**
- **Kurba e Philipsit në L-T është inelastike (vertikale)**
  - **Përbëhet nga shumë kurba të S-T**
- **Periudha 1: Ekonomia gjendet në pikën A, nuk kemi shok.**
- **Periudha 2: Ekspansion ekonomik => ↓u =>↑ pagat => ↑çmimet => ↑inflacioni => ekonomia lëviz në pikën B. Inflacioni i pritshëm nuk ndryshon.**
- **Periudha 3: Me rritjen e inflacionit, firmat dhe punëtorët fillojnë t'i ndryshojnë pritjet e tyre duke parashikuar inflacion më të lartë. Kurba e Philipsit zhvnedoset lartë, kur për çdo *u* kemi një normë më të lartë të inflacioni (Pikat B dhe C kanë *u* të njëjtë, por për pikën C inflacioni është më i lartë).**
- **Periudha 4: Për shkak të politikave makroekonomike dhe përshtatjeve të firmave dhe punëtorëve ndaj një normë më të lartë të inflacioni, ekonomia lëviz në pikën D.**

*Fig. 20.7: Kurba e Philipsit në periudha afatgjata*



# ...KURBA E PHILIPSIT: NË PERIUDHA AFATGJATA

**Konkluzioni: Krahaso pikat A dhe D:**

- Në pikën A: *u* është në nivelin natyror të saj dhe inflacioni është i ulët
- Në pikën D: *u* është e njëjtë si në pikën A por inflacioni i pritshëm është më i lartë
- Në të dy pikat A dhe D, GDP real është i njëjtë.

- Kur *u* është nën normën natyrore të saj
  - çmimet dhe pagat tentojnë të rriten. Kjo quhet *hipoteza e normës natyrore të papunësisë.*
- Spiralja nuk ndalet për sa kohë që *u ≠ norma natyrore e papunësisë,*

- Dy përfundime të rëndësishme nga teoria e normës natyrore të papunësisë:
  - → *Qeveria nuk mund ta çojë u nën normën natyrore pa shkaktuar inflacion*
  - → *Kurba e Philipsit tregon se qeveria duhet të zgjedh në mes të inflacionit dhe papunësisë (dmth ka trade-off në mes të inflacionit dhe papunësisë)*

# Pyetjet per ushtrime?

*Pyetjet per diskutim ne faqen 363*